



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.86/2017

Prishtinë, më 7.2.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Besim Beqaj, Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rrustem Berisha, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Sasha Milosavljeviç, zëvendëskryetar i dytë dhe Sala Berisha- Shala, anëtare.

Pjesëmarrës të tjerë: Visar Hoxha, KOSTT; Etleva Malushaj, LVV; Blerta Aliu, KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Veton Raci, si dhe Leutrim Krasniqi dhe Erëza Hasani, praktikantë të Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.1.2017;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-151 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për shkëmbimin dhe ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit– OST Sh. A. dhe/ose Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh. A.;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit të ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.1.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 31.1.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-151 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit– OST Sh. A. dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh. A.

Kryetari– Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, për më shumë sqarim, ia japim fjalën përfaqësuesit të KOSTT-it, për ta arsyetuar projektligjin, meqenëse nuk është i pranishëm përfaqësuesi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Visar Hoxha, KOSTT– Qëllimi i marrëveshjes në fjalë, është që KOSTT-i të marrë nga Republika e Shqipërisë shërbime ndihmese apo përkatësisht rregullimin sekondar dhe mbi suazat e bashkëpunimit me homologun tonë në Shqipëri për shërbimin në fjalë, OST. Ky shërbim është i domosdoshëm dhe parakusht teknik për një operim normal të KOSTT-it dhe përmbushjen e funksioneve ligjore sipas ligjeve në fuqi në Kosovë. Gjithashtu, është edhe obligim dhe kërkesë teknike e direktivave të Bashkimit Evropian, si dhe asociacioneve të Evropës. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, parashikohet që KOSTT dhe OST, të bëjnë dimensionin e përbashkët të kapaciteteve të shërbimeve ndihmese, ku do të krijohen mundësi për optimizimin në të dyja anët, gjithnjë duke pasur parasysh karakteristikat e dy sistemeve, të Kosovës dhe Shqipërisë. Ky shërbim, gjithashtu mund të ofrohet nga njësitë gjeneruese në Kosovë, por me kapacitet më të kufizuara, për arsye se karakteristikat teknike të kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike në Kosovë, kur dihet se ato janë termo dhe lëvizjet janë më të kufizuara.

Kryetari– Ne e përshëndesim këtë marrëveshje, gjithashtu edhe këtë projektligj që ratifikon këtë marrëveshje, për arsye se optimizon funksionimin e dy sistemeve, gjë që i kontribuon furnizimit më stabil, por ndërkohë edhe ndoshta çmimeve më të volitshme, sepse kur optimizohet funksionimi edhe ka më shumë mundësi për bashkëpunim dhe shkëmbim të energjisë, e cila është në dobi të konsumatorëve dhe furnizimit, si në sasi, ashtu edhe në cilësi. Gjithashtu, çështja që ne kemi të bëjmë këtu, ndërlidhet edhe me proceset integruese në Komitetin e energjisë dhe me asociacionin përkatës të distributorëve ENTSO-E. Megjithatë, duke e mbështetur në këtë marrëveshje, ne kërkojmë që dy shtetet, Qeveria e Shqipërisë dhe e Kosovës, bashkë me parterët e tyre dhe komitetin ndërkombëtar, të vazhdojnë me ngulm të kërkojnë që të anëtarësohet KOSTT-i në asociacionin e organizatave të distribucionit, sepse vetëm në atë mënyrë, ky sistem mund të optimizohet dhe të aktivizohet edhe interkoneksioni me kapacitetin e plotë. Çështja e tretë, është se ne jo vetëm që e mbështesim këtë, por do të kërkojmë që të fillojë hapi tjerët i ri,

në integrimin e dy sistemeve të operimit dhe shpërndarjes midis Shqipërisë dhe Kosovës, pra në dobi të optimizimit dhe furnizimit në sasi dhe cilësi dhe me çmime sa më të mira për biznese dhe për ekonomi familjare.

Fatmir Rexhepi – Është për t'u vlerësuar që më në fund, edhe praktikisht, po realizohen hapat konkretë për realizimin e marrëveshjes që ka bërë Qeveria e Shqipërisë dhe e Kosovës. Besoj që secili prej neve e ka mirëpritur dhe duhet t'i japim përkrahje projektligjit, që marrëveshja të realizohet. Është me interes të veçantë në fushën e energjisë, por edhe në çdo fushë tjetër që ka mundësi sa më shpejt që të përgatiten dhe të bëhen të gatshëm projektligjet, që të zbatohen ato marrëveshje, në mënyrë që të ecin përpara bashkërisht në fushën e ekonomisë, por edhe në fushat tjera që të krijojnë një partneritet të thellë ashtu qysh duhet të kemi ndër mjet veti.

Glauk Konjufca– Kjo marrëveshje është shumë e nevojshme për Republikën Kosovës dhe mirë që është bërë, por në të njëjtën kohë, ne këtu, herën e fundit kur e patëm ministrin, folëm për disa prej problemeve, me të cilat përballet sektori i energjetikes në Kosovë, edhe i prodhimit të energjisë, po ashtu kemi folur për anëtarësimin në ENTSO-E. Nuk e dimë se ku ndodhet tash Kosova në këtë proces. Herën e fundit, ministri ka thënë se do të anëtarësohemi shumë shpejt. Kjo, shumë shpejt, ka kaluar një kohë e konsiderueshme dhe ne nuk kemi kurrfarë raporti se ku ndodhet procesi tash për tash. E vetmja që shohim në marrëveshje, madje është përmendur edhe këtu në marrëveshje, ku thotë anëtarësimi i Kosovës në ENTSO-E. Çka do të thotë konkretisht ky avancim, a është bërë diçka prej para pesë muajve, prej kur e kemi pasur ministrin këtu? Cilët hapa janë bërë konkret në këtë drejtim? Nuk e di a është personi adekuat që mund t'u përgjigjet pyetjeve tona apo do të kishte qenë dikush nga ministria, mirëpo, është pyetje relevante. Po ashtu, sesi qëndrojnë punët me bllokadën e Serbisë, deri tash, se çka është bërë në këtë drejtim, dhe po ashtu, mendoj se sa i përket marrëveshjes, ajo që i mungon si suplementare, do të ishte ndoshta një protokoll pak më konkret i funksionimit dhe i zbatimit. Ne, si deputetë, duhet të jemi më të informuar, do të ishte mirë që t'i bashkëngjitej edhe ndonjë protokoll i funksionimit konkret me disa shifra dhe statistika se si qëndron sektori i prodhimit, aktualisht në Kosovë e kështu me radhë.

Besim Beqaj– Siç u tha, është një marrëveshje jashtëzakonisht e mirë, është një hap pas ndërtimit të linjës 403 KV, drejt integritetit të sistemeve energjetike të Republikës së Kosovës me Republikën e Shqipërisë. Normalisht, KOSTT-i dhe OST-i janë dy operatorë të sistemit të transmisionit, të cilët operojnë edhe me balanca energjetike që ndodhen në nivelin rajonal dhe qendra për shkëmbim të energjisë, ka qenë edhe kërkesë e Komitetit të energjisë, Traktatit të energjisë. Po ashtu, besoj që në takimin e fundit, të cilin e kishim, ajo është theksuar si njëra nga detyrat, që duhet të dalin, në mënyrë që të kemi një optimizim sa më të mirë të rrjetës. Lidhur me anëtarësimin, i cili duhet të bëhet, dhe duke marr parasysh edhe ecurinë, besoj që, ai kushti, sepse është një kusht për anëtarësim, kush të cilin ne e kemi thënë para tyre, sigurisht kur është thënë për avancimin e raporteve, nënkupton për funksionalizim të plotë në anëtarësimin, sepse këtu kërkohet një regjistrim i një ndërmarrje në veri, por që parimisht, besoj që Qeveria duhet të jetë shumë më këmbëngulëse, në këtë drejtim. Pra, si qendër apo si shkëmbim, përveç që mundëson funksionalizimin, është edhe një kontribut drejt ruajtjes së rolit të faktorit Kosovë, në këmbimet energjetike në nivel rajonal. Besoj që kjo marrëveshje do të mundësojë pastaj edhe shumë hapa të tjerë, të cilët do të jenë konkret, në drejtim të realizimit të integritetit të dy sistemeve tona energjetike, pra në mes të Shqipërisë dhe Kosovës.

Blerim Grainca –S’ka dyshim që kjo marrëveshje është më së e nevojshme dhe tash e sa kohë jemi duket e mirëpritur, dhe si të tillë, duhet ta përkrahim dhe ta shtyjme përpara. Megjithatë, mendoj se kjo marrëveshje i kontribuon fillimisht stabilizimit të furnizimit të dy të tretës, pasi që të dy vendet kanë probleme gjatë fazës apo gjatë sezoneve të caktuara, me furnizim të energjisë, verës apo dimrit. Po ashtu, mendoj se kjo do të ketë ndikim drejtpërdrejt edhe në çmimin e energjisë, që do të nxirret në treg dhe po ashtu do ta rregullojë edhe çështjen e importit dhe do të ketë efekt direkt tek ata që merren me tregti dhe me energji elektrike, si dhe furnizim me energji. I përshkruam vërejtët që u thanë, se do të duhej të ishte mirë edhe një shpjegim shtesë rreth kësaj, veçanërisht me çështjen financiare që lidhen me pritjen, me barazimet sesi do të bëhen kilovat për kilovat. Pra, do të bëhet barazimi me vlerat financiare, për arsye se një kilovat te ne, mund të kushtojë më shumë, ndërsa te ata më lirë. Pastaj, janë këtu çështjet operative, megjithatë do të duhej të ishin të përfshira, si pjesë plotësuese e marrëveshjes. Në parim, e mbështes dhe sugjeroj ta përkrahim të gjithë.

Kryetari– Konsideroj që Komisioni e përkrah, në përgjithësi, këtë marrëveshje. Konstatoj se është shumë e rëndësishme për optimizimin e funksionimit të dy sistemeve, stabilitetit në furnizim dhe furnizimin më racional, gjithashtu edhe ndërtimin e këtyre sistemeve dhe inkuadrimit të tyre në asociacionet e operatorëve të shpërndarjes. Njëkohësisht, në raport mund të japim një sugjerim që sa më shpejt të bëhet edhe protokollin i zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Një rekomandim tjetër, do të ishte që, dy shtetet të marrin masa për evitimin e pengesave që bën Serbia për anëtarësimin në ENTSO-E të KOSSTT-it, sepse vetëm atëherë, mund të fuqizohet dhe mund të jetësohet plotësisht kjo marrëveshje. Një qëndrim tjetër, është që ne të kërkojmë një informatë nga ekipi negociator, nga ministria, që të na informojnë ku janë pengesat për anëtarësim dhe çka po ndërlihdhet për tejkalimin e problemeve për anëtarësimin e KOSTT në ENTSO-E. Po ashtu, duhet të bëhet një amendament shtesë për datën e nënshkrimit, e cila mungon në projektligj, e që është 30.3.2016, ku autorizohet stafi ta hartojë amendamentin.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Projektligji nr. 05/L-151 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST Sh. A. dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh. A.

Amendamenti 1

Në nenet 1, 2 dhe 3 të projektligjit, në fund të tekstit, të shtohen fjalët si vijon: “e nënshkruar më datë 30.3.2016”.

Dhe, Kuvendit i paraqet këtë:

Rekomandim

- 1. Të miratohet Projektligji nr. 05/L-151 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit*

Ekonomik dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST Sh. A. dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh. A.

Amendamenti I

Në nenet 1, 2 dhe 3 të projektligjit, në fund të tekstin të shtohen fjalët si vijon: “e nënshkruar më datë 30.3.2016”.

- 2. I rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ministrisë përgjegjëse, që në bashkëpunim me partnerin nga Shqipëria, të zhvillojnë protokollin dhe të ndërmarrin masat tjera të nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.*
- 3. I rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës, që në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, të marrin masat për evitimin e pengesave nga Serbia, lidhur me anëtarësimin e KOSTT-it në ENTSO – E, e që është si një nga parakushtet kryesore për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.*
- 4. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.*

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158

Kryetari– Në mbledhjen e kaluar, kemi mbetur që sot të vijmë deri në konkluzion. Pra, në mbledhjen e kaluar, kemi diskutuar gjerësisht, ku i kemi dy çështje: 1. Aktivitetin në bazë të rekomandimeve dhe të konkluzioneve të Kuvendit, me rastin e monitorimit të Ligjit për miniera dhe minerale, ku është konstatuar që të shkohet me ndryshimin dhe me plotësimin apo me një ligj të ri për minierat; dhe 2. Iniciativa e deputetit Shaip Muja, lidhur me ndryshimin e Ligjit për miniera dhe minerale, të neni që ka të bëjë me tantiema. Në folëm gjerësisht herën e kaluar dhe sa i përket iniciativës, mendoj që nuk do të ishte racionale që të shkohet në dy drejtime d.m.th. në dy iniciativa, por që këto duhet të integrohen. Propozoj që iniciativa e deputetit Shaip Muja të integrohet në iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit apo të hartimit të ligjit të ri nga Komisioni. Gjithashtu, sa i përket tekstit të iniciativës së deputetit Muja, mendoj që ai tekst nuk është i përshtatshëm, sepse ne e kemi një tekst tjetër të ligjit për Trepçën, për shembull ku thuhet se këto mjete shkojnë në buxhetin e komunave, këto mjete nuk shkojnë në buxhetin e komunave, por në buxhetin e Kosovës, mirëpo lejohen me destinim që t'i menaxhojnë komunat për projektet e caktuara në komunitete, e jo në buxhet të komunave, prandaj teksti i amendamentit për ne është i papranueshëm.

Besim Beqaj– Në mbledhjen e fundit, nuk kam qenë dhe nuk e di si keni vendosur, por në dilemën që e kemi pasur, ka qenë se a do të bëjmë plotësim-ndryshim të ligjit apo do të bëjmë iniciativë për ligj të ri për miniera dhe minerale. Prandaj, si Komision, ne duhet të përcaktohem.

Duda Balje–Kemi problem me banorët e fshatit Hadë, lidhur me shpronësimin e pronave të tyre, ku realizohet veprimtaria minerare. Lidhur me amendamentin e propozuar nga deputeti Shaip Muja, për problemet e banorëve të fshatit Hadë, Ministria për Zhvillim Ekonomik, nuk ka dhënë

asnjë përgjigje. Prandaj, duhet të specifikohet sesi do të zgjidhet ky problem. Nuk e di se a mund që nga të hyrat e tantimës, që hyjnë në buxhetin e Kosovës, të përfitojnë edhe banorët e fshatit Hadë në zgjedhjen e problemit të pagesave për shpronësim.

Kryetari –Ti, si kryetare e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe anëtare e Komisionit, do të jesh në lidhje në mes dy komisioneve. Çështja e Hadës dhe shpronësimit, nuk mund të zgjidhet me tantimën. Problemi i tantimës ka një dimension tjetër. Pra, ajo është një çështje tjetër që duhet të zgjidhet me shpronësime. Propozoj që Komisioni të formojë një grup nismëtar, për të sjellë konkluzionin se a të shkohet me iniciativën e Komisionit për ligj të ri për miniera dhe minerale apo për plotësim-ndryshimin e tij. Propozoj që në këtë grup të jenë ish- grupi i punës, që e kanë monitoruar ligjin, dy përfaqësues nga Ministria për Zhvillim Ekonomik dhe dy përfaqësues nga KPMM-ja.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

Të mos miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158.

Dhe, Kuvendit i paraqet këtë:

Rekomandim

- 1. Të mos miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158.*
- 2. Qëllimi i kësaj nisme, të merret në konsideratë gjatë aktiviteteve të Komisionit për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit/hartimin e një ligji të ri për miniera dhe minerale.*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.*

Komisioni vendosi që të formojë një grup nismëtar për të sjellë konkluzionin për iniciativën e Komisionit për ligj të ri për miniera dhe minerale apo për plotësim-ndryshimin e tij, si vijon: Sala Berisha – Shala, kryesuese, Besim Beqaj, Blerim Grainca, Rrustem Berisha, Enver Hoti nga Komisioni; drejtori për Miniera dhe drejtori i Departamentit Ligjor nga Ministria për Zhvillim Ekonomik, si dhe Musa Shabani dhe Azem Rexhaj, nga KPMM-ja. Pas arritjes së konkluzionit, grupit do t'i bashkohet edhe kryetari z.Mustafa, zëvendëskryetar i parë, z. Konjufca dhe anëtari i Komisionit, z.Qela.

5. Të ndryshme **Çështjet vijuese**

Fatmir Rexhepi –Kërkoj nga kryetari i Komisionit se a ka informatë apo a ka pasur ndonjë takim me ministrin e Zhvillimit Ekonomik, se a është në rend dite ndërtimi i termocentralit “Kosova e

Re” dhe a do të fillojë këtë vit?

Kryetari – Është duke u punuar në atë drejtim. Po ashtu, është diskutuar një kontratë, por për të mos spekuluar, ne po kërkojmë prej ministrisë një informatë të shkurtër për ecurinë lidhur me “Kosovën e Re”, si kanë shkuar proceset dhe dilemat, nëse ka, dhe pritjet në të ardhmen.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Blerim Grainca –Z. kryetar, meqë është në procedurë hartimi i pakos së dytë fiskale, duke ditur ndikimin që ka edhe në gjithë ekonominë, edhe në zhvillim ekonomik, propozoj që në njërin nga takimet e ardhshme, të ftohet në takim ministri i Financave, për ta diskutuar bashkërisht këtë pako dhe për të dhënë sugjerimet dhe rekomandimet që kemi ne, si deputetë. Mendoj se kjo është e nevojshme të bëhet para se kjo të vijë në Kuvend.

Kryetari – Pakoja e dytë fiskale ende është në konsultime, ende s’ë ka miratuar Qeveria, por neve nuk na pengon që ndoshta edhe para miratimit të Qeverisë, por para se të vijë në Komision, të konsultohemi.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Raif Qela– Lidhur me ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike dhe pasojat që i ka kjo për ekonominë e Kosovës, desha ta shqyrtojmë si nënpikë. Para një kohe, ne si Komision, kemi kërkuar prej ZRRE-së një raport lidhur me ndërprerjen e paarsyeshme të energjisë, jo në përputhje me planet e tyre. Ai raport nuk na ka ardhur kurrë, me sa e di. Duhet të kërkojmë përgjegjësi për këtë, në njëfarë mënyre, edhe zotimin e vet e kanë shkelur. Pra, shumë çështje kanë mbetur pezull, të pasqaruara, e aq më parë, për shembull dje në disa zona dhe ndërmarrje ka pasur ndërprerje të rrymës, edhe pse KEK-u është venë në funksion, ka pasur ndërprerje disa orë. Pasojat e kësaj po i shohim çdo ditë, mandej ka edhe rreziqe që të na ikën investitorët prej këtu, për shkak të mungesës së energjisë.

Kryetari – Sa i përket kësaj, Raifi ka plotësisht të drejtë. Ju e dini që ne e mbajtëm mbledhjen këtu, ku raportoi ZRRE-ja. Mbase raportoi ZRRE-ja, u demantua ajo se çka raportoi ZRRE-ja, sepse mbase dite, ku kërkuam se pse po ndalet rryma, në gjashtëdhjetë vende nga katër orë, ata na e dërguan një raport neve, në të cilin thanë se kanë gjetur disa parregullsi te KEDS-i. Lidhur me këtë, ata na e dërguan një raport preliminar, por na premtuan se do të vijë edhe raporti detal, por raporti detal nuk na ka ardhur. Ne do të kërkojmë një sqarim me shkrim nga ZRRE-ja, se pse nuk na ka ardhur raporti i dytë dhe duhet të kërkojmë sqarime se çka ka ndodhur me ato konstatime lidhur me ndërprerjen e rrymës. Pra, të na e dërgojnë një raport brenda dy jave, mandej ne vendosim a do ta vëmë në rend dite këtu apo jo.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Besim Beqaj – Një debat që e kemi pasur me deputetin Berisha, sa i përket monitorimit të ndërmarrjeve publike, dua t’i korrigjojë mediat, të cilat kanë dhënë informatë të pasaktë, informatë të gabuar dhe më duhet të them që ka qenë e qëllimshme. Pra, unë këtu kam thënë se duhet të dallohet autoriteti funksional dhe autoriteti i të drejtës së anëtarëve të Kuvendit për t’u

informuar për secilën çështje. Nëse ka pasur keqkuptime nga mediat, është e pranueshme, nëse ka pasur tendencë për të raportuar se unë kam qenë refuzues për mosmonitorim, atëherë po na çon drejt disa informacioneve, që nuk janë të sakta. Pra, unë dua të them që, nuk kam thënë ashtu. Lidhur me këtë, ekzistojnë të gjitha të dhënat, të cilat regjistroheshin nëpër takime, edhe transkriptat dhe iu kisha lutur që t'i referoheni kësaj çështjeje. Kjo ka të bëjë me portalin "Lajm" dhe sigurisht pastaj e kanë përcjellë edhe portalet tjera. Një çështje tjetër, që kisha dashur ta ngre, është debati për pagat. Ligji për pagat nuk ka ardhur në Kuvend, kështu që do të ishte krejtësisht e papërgjegjshme, profesionalisht, për të folur për Ligjin e pagave, përderisa ligji nuk ka ardhur në Kuvend asnjëherë. E dyta, është se çdoherë, sa herë që është raportuar, është raportuar gabimisht, prej të gjitha mediave, sepse është thënë se deputetët marrin për një seancë nga 240 euro dhe rritet me ligjin e ri mbi 260 euro, pra dua t'ju informoj se është informatë e gabuar. Deputetët, nga të gjitha pranitë në seanca, maksimum brenda muajit mund të marrin 240 euro. Pra, të gjitha seancat në nivel të muajit. Ju rekomandoj të gjithëve, që t'u referoheni dokumenteve edhe sa i përket pagave të deputetëve, edhe sa i përket mëditjeve, si dhe sa i përket të gjitha gjërave, i keni në administratë dhe mund t'i shihni. Të gjitha mediat edhe të gjithë të pranishmit, edhe shoqëria civile, janë përgjegjës për plasimin e informacionit jo të saktë.

Enver Hoti –Unë mendoj që ajo çështja e pagave për deputetët, që ka filluar të trajtohet në opinion nga mediat, nuk duhet të na shqetësojë shumë. Ne duhet të jemi transparent, mirëpo edhe qytetarët kanë mundësi ta dinë, por ato edhe të trajtohen, pse jo, madje i kisha inkurajuar mediat që t'i trajtojnë edhe pagat e ndërmarrjeve të ndryshme, bordeve, agjencive, sepse ka një mos-transparencë në këtë drejtim.

Rrustem Berisha– Ngriti çështjen e bizneseve në Kosovë, që po ankohen për zgjidhjen e kontesteve biznesore. Ankesat, shumica prej tyre, janë në gjykata, derisa po i zgjidh ato konteste, që realisht po vjetërsohen, po e humbin efektin, diku janë 2400 lëndë që janë në pritje. A ka ndonjë mundësi që të bëhet diçka për të përshpejtuar këtë çështje ose për t'iu drejtuar organeve përgjegjëse, që të marrin ndonjë raport zyrtar? Sa i përket çështjes që e ngrihi deputeti Beqaj, unë mendoj që s'ka pasur aty asnjë problem. Ne e kemi diskutuar çështjen e programit të Komisionit, dhe në kuadër të programit, e kemi dhënë si propozim, që edhe ne si deputetë, kemi të drejtë të kërkojmë që të mbikëqyrim marrëveshjet që janë bërë në lidhje me Aeroportin edhe me KEDS-in edhe sigurisht të informohemi, sa po zbatohen ato. Pra, është e drejta jonë, nuk ka asgjë që është diskutabile.

Kryetari– Është shqetësues debati për Ligjin për pagat, për të cilin ne as që e kemi në procedurë në Kuvend, as nuk është proceduar ende. Kur të vijë në Kuvend, ne i japin vlerësimet tona. Sa i përket kontesteve biznesore, ne, tri herë e kemi diskutuar vjet këtë çështje, për shkak të rëndësisë së saj, i kemi përfundimet, i kemi rekomandimet, po ashtu kemi bërë edhe amendament në buxhet, por nuk ka kaluar. Fatkeqësisht, po shkon ngadalë zbatimi i rekomandimeve. Ne do të kërkojmë informatë për zbatimin e rekomandimeve nga Ministria e Financave, për buxhet, edhe nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Këshilli Gjyqësor, dhe në mbledhjen e radhës, të diskutojmë.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Blerim Grainca –Në vitin e kaluar, kemi mbajtur një mbledhje të përbashkët me Komisionin për Zhvillim Ekonomik të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, dhe në frymën e marrëveshjeve,

kemi rënë dakord që t'i bëjmë tri a katër çështje, për të parë deri ku kanë mbërritur të realizohen, për arsye se po i shohim edhe problemet që ka komuniteti i biznesit, në raport me Republikën e Shqipërisë. Prandaj, ju propozoj që ta nxjerrin si rekomandim, qoftë prej Qeverisë, qoftë nga ministritë përkatëse, të shohim deri ku kanë mbërritur këto çështje. Pra, kjo çështje të trajtohet dhe të hyjë si pikë e veçantë, në njërën nga mbledhjet e ardhshme.

Kryetari –Kam pasur edhe një kontakt me ambasadorin e Shqipërisë, edhe ai është i interesuar që t'i zgjidhim këto çështje. Me këto çështje, gjithashtu kam biseduar edhe me zëvendëskryeministrin, Ramiz Kelmendi dhe besoj që duhet t'i evidentojmë këto tri a katër çështje, që t'i shtyjmë dhe t'i zgjidhim, në të ardhmen e afërt.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:15.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa